


# Semafori i Koronës në qendrat e arsimit dhe të edukimit të fëmijëve



## Zhvillimi i aktiviteteve nën masat më të larta të mbrojtjes (Rrezik shumë i lartë)

Përveç (si shtesë) fazës së portokallt do të zbatohen edhe kërkesat në vijim:

- Mbjtja e maskës mbrojtëse është gjithashtu e detyrueshme edhe për personelin e përkujdesjes gjatë përkujdesjes
- Lejohet mosardhja e fëmijës suaj në vitin e përkujdesjes me detyrim - kontakti me anë të telefonit është i mundur

## Zhvillimi i aktiviteteve nën masat e larta të mbrojtjes (Rrezik i lartë)

Përveç (si shtesë) fazës së verdhë do të zbatohen edhe kërkesat në vijim:

- Dorëzoheni fëmijën tuaj në zonën e dakorduar (të caktuar paraprakisht)
- Nuk do të mbahen mbledhje të prindërve dhe festa – bisedat me prindërit do të mbahen vetëm me telefon
- Ofertat e jashtme (p.sh. higjiena e dhëmbëve) nuk do të mbahen
- Nuk do të përzihen grupet
- Gjymnastika dhe këndimi do të mbahen vetëm në ambiente të hapura.

## Funksionimi normal nën masat e përforcuara të higjienës (Rrezik i moderuar)

Përveç (si shtesë) fazës së gjelbër do të zbatohen edhe kërkesat në vijim:

- Mbjtja e maskës mbrojtëse në hyrjen e shkollës
- Gjymnastika dhe këndimi do të mbahen kryesisht në ambiente të hapura.

## Funksionimi normal me masa paraprake të higjienës (Rrezik i ulët)

- Në hapësirat e institucionit vëmendja do t'i kushtohet masave më të rrepta të higjienës - në rast se keni pyetje, drejtoheni tek përgjegjësi/sja e qendrës (menaxheri/menaxherja e objektit)
- Mbani një distance prej të paktën 2 m. Në rast se kjo nuk është e mundur, vendoseni maskën mbrojtëse
- Shmangni formimin e grupeve me prindër, persona të përkujdesjes dhe me fëmijë në qendër
- Lani respektivisht dezinfektoni duart para se të hyni në qendër
- Kufizoni qëndrimin tuaj në objekt/institucion në minimum

**E rëndësishme:** Mos e sillni fëmijën tuaj në institucion nëse fëmija, prindërit respektivisht kujdestarët ligjorë ose familjarë të tjerë të shtëpisë nuk janë mirë me shëndet (me temperaturë, kollitje, dhimbje fyti, vështirësi në frymëmarrje)!